Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 506/19
Datë/Datum. 17.10.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.506/19

PANELI SHQYRTUES,i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërjetë z.Blerim Dina - Kryetar ,z.Nuhi Paçarizi - Referues,z. Goran Mileković- anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik:OE" Pharma Leader LLC "- Prishtinë , kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: " Liri Med " SH.P.K , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:" Furnizim me barna esenciale për FSSH dhe DF në MSH-Lot 10 ", me numër të prok: 206-18-1227-111,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues/AK/, Ministria e Shëndetësisë,/MSH/më datë: 23.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET , pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik" Pharma Leader LLC "- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " Furnizim me barna esenciale për FSSH dhe DF në MSH-Lot 10 ", me numër të prok: 206-18-1227-111, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues/AK/, Ministria e Shëndetësisë/MSH/.

II.ANULOHET, njoftimi për dhënien të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " Furnizim me barna esenciale për FSSH dhe DF në MSH-Lot 10 ", me numër të prok: 206-18-1227-111, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues/AK/, Ministria e Shëndetësisë, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV.Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues " Pharma Leader LLC "- Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Afati për dorëzimin e ofertës ka qenë deri më: 30.03.2018
Data e njoftimi për kontratë është bërë me dt: 05.03.2018-2019.
Kërkesa për rishqyrtim është bërë me dt: 05.08.2019
Vendimi i AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim bërë me dt: 06.08.2019

Operatori ekonomik ankues:" Pharma Leader LLC " - Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me dt.14.08.2019, me nr.506/19,kundër njoftimit për dhënie të kontratëslidhur me aktivitetin e prokurimit me titull prokurimit:" Furnizim me barna esenciale për FSSH dhe DF në MSH-Lot 10 ", me numër të prok:206-18-1227-111,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Ministria e Shëndetësisë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet:1,6, 7, 59, 60, 64, dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë:28.08.2019, ka autorizuar ekspertin shqyrtues dhe ekspertin teknik të jashtëm, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues dhe eksperti i jashtëm teknik,në raportin e dt: 09.09.2019, sqaronsi ne vijim : Pretendimi kryesor dhe i vetëm ankimorë nga OE ankues Pharma Leader, është se për Lot.10 OE i rekomanduar për kontratë ka aplikuar normën e gabuar të TVSH-së prej 0%. Lidhur me këtë pretendim OE ankues ka ofruar si dëshmi përgjigjen e marrë nga Doganat e Kosovës, në të cilën sipas OE ankues konfirmohet se produkti në fjalë ka normën e TVSH prej 8%. Në të njëjtën kohë OE i rekomanduar për

kontratë i pretendon se produktin e kërkuar në lot.10 e ka importuar me 0% TVSH sipas vendimit ë Doganave të Kosovës.

Nga shkresat e lëndës në dispozicionit , eksperti teknik dhe eksperti shqyrtues nuk mund të konstatojnë se produkti "FERRIC HYDROXIDE sol për inj 20 mg / ml" se a ka normë të TVSH-së 0% apo 8%, pasi që janë dy dëshmi kundërthënëse nga Dogana e Kosovës.

Me gjithë atë ekspertët shqyrtues konstatojnë se është nevojshme që përfundimisht të konstatohet-vërtetohet nga AK dhe Doganat e Kosovës se sa është norma e saktë e TVSH-së për produktin "FERRIC HYDROXIDE sol për inj 20 mg / ml', dhe pasi të konfirmohet norma e TVSH-së për këtë produkt , kjo normë të korrigjohet nga AK sipas dispozitave ligjore.

Mendimi i ekspertit shqyrtues / teknik: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar, për arsyet te cilat u ceken ne Raport te Ekspertizës dhe lënda te kthehet ne Ri-vlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 10.09.2019 , me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë:11.09.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, sepajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës:23.09.2019, ku kanë qenë prezent gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesi i OE-së ankues, përfaqësuesit AK-së, si dhe ekspertet shqyrtues dhe teknik, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE- z. Sadiki deklaroj: Është një produkt tepër pacientet ne hemodialize dhe ketë produkt e kanë te domosdoshëm sa i përket qeshjes se sqarimit është tejzgjatur , unë mendoj se Ak nuk i ka marr parasysh shume argumente te organeve përgjegjëse për tarifim me qenes e behet për produkt plotësisht te njëjtë si nga ne dhe te rekomanduarit liri med, ne paguajmë TVSHn pas kërkesës për sqarim te zyrës se doganave është marr përgjigjja se ky produkt me ACTCOD B03 AC 02 qe

i kemi te njëjtë te dy ofertuesit paguan TVSH-ne atë ne 38% ne te njëjtën kohe është shqyrtuar edhe vendimi i sektorit për shqyrtim te ankesave i cili e liron ketë produkt te Lirimet, por kërkon sqarime nga MAsh dhe agjencioni i barnave qe nuk janë kompetente për te vlerësuar a kanë TVSH apo jo. Ky sektor për shqyrtimin e ankesave është bazuar ne ligjin 04L/-163 pjesa D për mallrat e liruara nga tatimi ky produkt fare nuk është ne këtë listë por është produkti ME ATCK B03 AB 04 poashtu ne kërkesën e juaj është kërkuar drejtorit te degës ne Aeroport e jep një sqarim ku sektori për kundërvajtje e kthen se ky produkt paguan TVSH ndërsa Sektori i ankesa ve e anulon këtë vendim ne përgjigjën e doganave ne aeroport thotë se për ekspertize te mëtutjeshme duhet ti drejtoheni organeve Siç janë Sektori i Tarifave, Zyra ligjore zyra për interpretim e nga ky sektor është marr përgjigja se ky produkt paguan TVSh, por e kemi edhe një interpretim te KRPP-së pyetjet e shpeshta 46. Ne këtë rast AK nuk e ka respektuar interpretimin e KRPP-së nuk jemi trajtuar te barabartë. I dorëzoj panelit dëshmitë e produkteve te njëjta.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Thaqi deklaroj: Se pari nuk është OE tha qe Dudat Doganor, sa i përket çështjes ne si Ak ju njoftojmë se për ketë prokurim ekzistojnë 3 vendime te OSHP-së ne rivlerësim. I rekomanduar për kontrate i kemi shtuar TVSh-n dhe nuk kanë kaluar kësaj radhe kemi rekomanduar për kontrate ofertën me te lire ne harmoni me kriteret kryesore duke u bazuar ne dokumentet zyrtare Doganore dhe kemi vendosur te mos diskreditojmë asnjë pale me shtimin apo heqjen e TVSH-se, kemi pranuar norma te TVSH-se ashtu siç kanë ofruar dhe dorëzuar me dokumentet e mallit. Sa i përket pyetjes se KRPP-së nr 46 poashtu nuk mund te konsiderohet trajtim jo i barabartë i OE-ve pasi ne i kemi trajtuar ofertat e 2 OE-ve ashtu siç e kanë dëshmuar vete me dokumente doganore te importit te mallit dhe sa i përket normës se TVSh ne nuk jemi autoritet kompetent te caktojmë norma te TVSh-së. Dogana ju ka thënë juve (OSHP-se) ka thënë se kjo sasi është e importuar pa TVSH. I dorëzojmë panelit dëshmi Vendimin qe është i liruar nga Dogana 1165 te datës 30.10.2018 qe kjo sasi e barnave lirohet nga Dogana. Por jemi te obliguar ti zbatojmë vendimet e Autoriteteve kompetente ne ketë rast Dogana, ndërsa ndonjëri nga OE mendohet se nuk ethe trajtuar i barabartë për caktimin e normës se TVSH-se për këtë mund ti drejtohet Autoritetit kompetent Doganës se Kosovës.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Halili deklaroj: Nëse norma e TVSH-se, është 8% duhet te jetët e njëjtë për te gjithë OE-te, nëse norma e TVSH-se është 0% poashtu duhet te jete për te gjithë e njëjtë.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z. Sadiki deklaroj: Kërkojmë te aprovohet ankesa jone si e bazuar dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së z.Thaqi deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues te hedheposhtë ankesën e OE-se dhe te mbetet ne fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas analizimit të gjitha shkresave sqaron se pretendim ankimor i OE ankues është se është rekomanduar për kontratë OE të cilit nuk i është llogaritur TVSH-ja për produktin "Ferric Hydroxide Sucrose complec" me ATC Code B03AC02, ndërsa OE ankues i është llogaritur me arsyetimin se ky produkt ka TVSH në vlerë prej 8 %.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në të gjitha dëshmitë, faktet dhe argumentet që ka pasur në dispozicion, si dhe në sqarimet e ekspertit shqyrtues konstaton se ky aktivitet i prokurimit duhet të kthehet në rivlerësim dhe gjatë rivlerësimit, autoriteti kontraktues duhet të qartësojë dhe vërtetojë se produkti "Ferric Hydroxide Sucrose complec" me ATC Code B03AC02 a lirohet nga detyrimi tatimor apo jo, nëse nuk lirohet të qartësohet se sa për qind i detyrohet tatimit doganor ky produkt.

Paneli shqyrtues konstaton se të dy operatorët ekonomik (fituesi dhe ankuesi) kanë ofertuar për produktin e njëjtë me ATC kode të njëjta, prandaj për të dy operatorët ekonomik duhet të vlejnë rregullat e njëjta, e jo për një operator ekonomik të zbatohet norma e TVSH-së ndërsa për tjetrin të mos zbatohet. Nëse ka TVSH i njëjti produkt të vlejë tarifa e njëjtë për të gjithë operatorët ekonomik, nëse nuk ka TVSH përsëri të zbatohet për të gjithë operatorët ekonomik e njëjta rregull.
Paneli shqyrtues obligon autoritetin kontraktues që të qartësojë në detaje çështjen e TVSH-së në lidhje me këtë produkt dhe gjatë rivlerësimit duhet të ketë parasysh edhe interpretimin e KRPP-së të dhënë në përgjigjen tek pyetja nr.46.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në dëshmitë që ka pasur në dispozicion, sqaron se ekziston shkresa e dt:03.05.2019 ku z.Ismet Hyseni ka kërkuar sqarime nga Kabineti i Drejtorit të Përgjithshëm të Doganës se produkti "Ferric Hydroxide Sucrose complec" me ATC Code B03AC02 a lirohet nga detyrimi tatimor. Ndërsa me dt:08.05.2019 Kabineti i Drejtorit të Përgjithshëm të Doganës ka dërguar sqarimet duke sqaruar si në vijim: "Sipas Ligjit nr.04/L-163 për Mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor pjesa D, produkti medicinal "Ferric Hydroxide Sucrose complec" me ATC Code B03AC02", nuk lirohet nga detyrimi tatimor dhe se i njëjti i nënshtrohet taksës prej 8%.
Gjithashtu operatori ekonomik ankues ka prezantuar dëshmi ku me dt:18.01.2019 i është drejtuar sektorit të tarifave, konkretisht z. Ekrem Grabanica për sqarime në lidhje me këtë produkt, ndërsa me të njëjtën datë i është kthyer përgjigje ku shkruan se **produkti ATC Code B03AC02 nuk lirohet nga detyrimi**

tatimor dhe i nënshtrohet detyrimit tatimor prej 8 %, ndërsa në vazhdim të sqarimit shkruan: Besoj se këtu kemi një keqkuptim me Ferric Hydroxidet me ATC Code B03AB04, i cili lirohet nga detyrimet doganore dhe tatimore.

Lidhur me arsyetimin e autoriteti kontraktues, ku në raportin e vlerësimit e ka cekur se në pamundësi ligjore që ta obligojë OE Lirimed që ta shtoj normën e TVSH-së nga 0% në 8% për arsye se Dogana e Kosovës me vendimin nr.protokoli 1165 të dt:30.10.2018 e ka liru nga TVSH-ja, e kanë rekomanduar për kontratë me çmim më të ulët, paneli shqyrtues sqaron se obligim i AK-së është të vërtetojë se produkti **ATC Code B03AC02** a ka TVSH apo jo dhe nëse ka atëherë të përdor standard të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomik, ndërsa nëse nuk ka përsëri të përdor standardin e njëjtë.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z.Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK -Ministria e Shëndetësisë/MSH/

1x1 OE -" Pharma Leader LLC "- Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim nëweb- faqe të OSHP-së.